

KUVENDI MBARËKOMBËTAR
“VAZHDIMËSIA HISTORIKO-GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE E
SHQIPTARËVE PËRMES MIJËVJEÇARËVE”

Referat

Lidhja pellazgo-ilir⁰ -shqiptare në studimet e gjuhëtarëve dhe historianëve gjermanë të shekullit të kaluar

Fiset parahelene në studimet e kohëve moderne

Me krijimin e shkencës së Gjuhësisë Krahasuese, historianët dhe gjuhëtarët gjermanë do të drejtonin vëmendjen edhe tek gjuhët e fiseve të antikitetit, tek fiset Pellazge dhe Ilire, si banuesit më të hershëm të njohur të kontinentit tonë.

Duke u bazuar tek të dhënat e të gjithë trashëgimisë historike të arritur deri në ditët tona nga antikiteti, historianët e kohëve moderne do të arrijnë në përfundimin që territoret, të cilat banohej sot nga grekët kishin qënë në antikitet të banuara nga një popullsi tjetër shumë herë më e vjetër - JO GREKE - për emërtimin e së cilës ata do të përdorin shpesh një emër të përbashkët - emrin Pellazgë. Nën këtë emër studiuesit e kësaj periudhe do të përmbledhin të gjitha fiset e antikitetit, të cilët kishin banuar territoret e Greqisë antike, ishujt e Egjeut dhe të Azisë së Vogël përpara se grekët të vinin në këto anë. Trashëgimia më e hershme letrare - Iliada dhe Odiseja – mitologjia e vjetër, sie dhe historianët e periudhave pasardhëse i përshkruajnë këto fise me emrat e tyre si: Lelegët, Lydët, Lykët, Mysët, Karët, Dioi Pelasgoi, Musoi, Frygët, Meonët, Thrakët etj. tregojnë shtrirjen e tyre gjeografike, hyjnitë që ata besonin, lidhjet fisnore midis tyre.

Për ndryshimin etnik midis fiseve pellazge dhe greke do të sillej si dëshmi nga autorët e kohëve të reja së pari vetë trashëgimia historike e helenëve, e cila i përcakton këto fise si “barbare” me kuptimin - “fise që flasin një gjuhë tjetër të ndryshme nga gjuha greke”. Vetë autorët helenë do i përshkruajnë këto fise në veprat e tyre shpesh si - “popuj të huaj, të ndryshëm nga grekët”, kurse kulturën e tyre do e vlerësojnë si - “të ndryshme nga kultura greke”. Edhe mënyra e jetesës dhe zakonet e këtyre fiseve, të cilat ata do ti ruanin të pandryshuara deri në kohët historike, do të vlerësoheshin nga autorët helenë si – “të ndryshme nga zakonet dhe jeta greke”.

Në veprat e këtyre autorëve do të flitet edhe për shpërnguljen e pellazgëve pasi grekët kishin ardhur në këto anë. Pas shpërnguljes nga trojet e tyre të vjetra pellazgët do të endeshin për një kohë të gjatë nëpër Greqinë antike derisa të gjenin një vend të ri banimi. Për këtë arsye u quajtën shpesh me përbuzje nga grekët si - “popull endacakë”. Në të vërtetë pellazgët kishin qënë popull i ngulitur , - theksojnë historianët e kohëve të reja, - sepse ata merreshin me bujqësi. Shpërngulja e pellazgëve dhe vlerësimi që helenët i bëjnë kësaj popullsie të vjetër bëhen dëshmi e ndryshimit etnik midis tyre dhe helenëve të ardhur.

Edhe analiza e materialit mitologjik të trashëguar nga kjo periudhë e hershme e historisë, analiza e poemave homerike, e të dhënave arkeologjike, si dhe studimet e kryera në fushën e gjuhësisë krahasuese mbi gjuhën e këtyre fiseve do të dëshmojnë për ndryshimin etnik midis fiseve pellazge dhe fiseve helene.

Në këtë referat do të përqëndrohem kryesisht në dallimin midis gjuhës së fiseve të antikitetit dhe helenëve të ardhur, të nxjerra nga studimet e kryera mbi bazën e gjuhësisë krahasuese të kohëve moderne.

Huazimet e grekëve nga kultura e lashtë pellazge

Studiuesit e kohëve të reja do t'ju atribuojnë Pellazgëve një kulturë shumë herë më të lartë se kultura e mëvonshme greke dhe do të pranojnë që helenët e ardhur më vonë në këto treva do mësonin në fusha të ndryshme të jetës prej kulturës së fiseve pellazge. Vetë Grekët do e vendosnin veten e tyre në një nivel shumë herë më të lartë kulturor se pellazgët, ndërsa popullsinë e lashtë paragreke do ta karakterizonin shpesh me konceptet – “jogrek, jo të lirë, dhe të paditur”. Një vlerësim që përcakton qartë ndarjen etnike midis fiseve pellazge dhe greke.

Historianët e kohëve të reja përmendin një sërë fushash nga të cilat grekët do të mësonin nga pellazgët. Në radhë të parë Grekët do të përfitonin prej njohurive të pellazgëve në fushën e bujqësisë. Pellazgët do të bëhen mësuesit e tyre në trajtimin dhe përpunimin e tokës. Duke qënë popull i ngulitur ata kishin mbledhur një përvojë shumë të gjatë në këtë fushë, kishin bërë shpyllëzimin e vendit dhe kishin punuar për urbanizimin e tij. Vetë kultet e pellazgëve apo emrat e hyjnive të tyre tregojnë për lidhjen e tyre të ngushtë me tokën, si p.sh. kulti i Demetrës, ndërsa vetë Pellazgu përmendet në mitologjinë e tyre si – “i linduri nga toka”.

Grekët do të mësojnë prej pellazgëve edhe artin e ndërtimit. Pellazgët zotëronin njohuri të veçanta dhe një teknikë shumë të përparuar për kohën në fushën e ndërtimit, veçanërisht në ndërtimin e banesave.

Prej pellazgëve do të mësojnë helenët edhe artin e përpunimit të gurit dhe bashkë me të do të fusin në gjuhën e tyre edhe një numër fjalësh të kësaj fushe, të cilat i përkisnin gjuhës së kësaj popullsie të lashtë, p.sh. fjalën “plinthos” me kuptimin “tjegull”. Në këtë formë kjo fjalë gjendet e pandryshuar akoma në shqipen e sotme - “plithi i dheut”, “plithar për ndërtimin e shtëpive”. Gjuhëtarët përmendin edhe fjalën “thellumnon” me kuptimin “fundament”, e cila ka hyrë në gjuhën greke po nga gjuha e kësaj popullsie të vjetër. Edhe kjo fjalë është e krahasueshme me fjalën e shqipes së sotme “thellon, vend i thellë, fundament”.

Prej pellazgëve grekët do të mësojnë edhe përpunimin e metaleve dhe do të fusin në gjuhën e tyre edhe vetë fjalën “metal”, prej gjuhës së kësaj popullsie të vjetër. Edhe një numër fjalësh, të cilat emërtojnë sende të përdorimt shtëpiak, grekët do t'i huazojnë po nga gjuha e fiseve pellazge, midis të tjerash edhe vetë fjalën “Keramos - qeramik!” – thonë gjuhëtarët. Edhe kjo fjalë është ruajtur në këtë formë në shqipen e sotme.

Një nga veprimtaritë më të rëndësishme që grekët do të mësonin nga pellazgët, e cila do të influenconte thellë jetën e tyre ishte - lundrimi detar. Sëbashku me këtë veprimtari do të hyjnë në fjalorin grek edhe një numër fjalësh, të cilat lidhen ngushtë me lundrimin detar, midis të tjerash edhe vetë emërtimi për detin “thallasa”, i cili i përket gjuhës së fiseve pellazge.

Edhe fusha të tjera të jetës helene do të influencohen nga bota e kulturës pellazge. Nga popullsia parahelene grekët do të huazojnë edhe një numër fjalësh të njohura si fjalë kulture. Rruga e huazimit të fjalëve të kulturës ndërmjet dy popujve është gjithmonë me kahun nga kultura më e lartë drejt kulturës më të ulët. Grekët do të mësonin prej pellazgëve edhe mënyrën e organizimit shtetëror, për të cilin ata do të krenohen më vonë para pellazgëve, - shkruan Thumser. Pikërisht kjo mburrje mbi aftësinë e tyre për krijimin e një shteti të centralizuar, bëhet tregues i faktit që Grekët ishin të ndërgjegjshëm për ndryshimin që ekzistonte midis tyre dhe Pellazgëve,- shkruan Hesselmeyer. Mënyra se si fiset pellazge e organozinin jetën e tyre mbështetej në ligje të natyrshme, të trashëguara nga thellësitë e kohërave, të cilat kishin një kuptim shumë të thellë për jetën, për zhvillimin dhe organizimin e saj, për ekzistencën njerëzore, të cilat nuk mund t'i kuptonin dot grekët e ardhur, prandaj ata do të zgjidhnin formën e krijimit të shtetit të centralizuar si mënyrën e tyre për të organizuar jetën, për të ushtruar sundimin. Pikërisht kjo mënyrë e oraganizimit të marrëshënieve

njerëzore ndryshon në thelbin e saj si nata me ditën nga mënyra e organizimit të jetës tek fiset pellazge.

Edhe emërtimet që lidhen me shtetin dhe organizimin e tij, me ushtrimin e pushtetit dhe sundimin - janë huazime të grechishtes nga materiali gjuhësor i pellazgjishtes,- vënë në dukje studiuesit e kohëve të reja. Në mungesë të fjalëve të gjuhës së tyre, që lidheshin me këto veprimtari, helenët ishin të detyruar që t'i huazonin ato nga gjuha e fiseve që gjetën, kur ata erdhën në këto anë,- vënë në dukje studiuesit. Tek këto huazime mund të përmenden edhe elementet e kalendarit, fjalë të fushës së tregëtisë si dhe një numër fjalësh të tjera nga fusha sociale.

Edhe vetë Arti i fiseve të antikitetit parahelenë, i cili në vetvete paraqitet - "i njëjtë, unik, homogjen" - tregon një karakter shumë specifik, i cili është shumë i ndryshëm nga arti i mëvonshëm helenë,- shprehen studiuesit e kohëve të reja.

Prej pellazgëve do të mësojnë grekët edhe mitologjinë si dhe mësimet e perëndisë,- theksojnë studiuesit. Të gjitha emrat e hyjnive të mitologjisë së lashtë antike i përkasin fondit të periudhës parahelene, janë emra me prejardhje pellazge. Nëse grekët do ta kishin sjellë me vete këtë mitologji, ata nuk do t'i kishin thërritur kurrë emrat e hyjnive të tyre me emrat e një gjuhe të huaj. Figura të poezisë homerike, të botës mitologjike, të legjendave dhe gojëdhënave mbajnë emra - jo grekë, i përkasin fondit të gjuhës së popullsisë së lashtë pellazge, - do të shprehen studiuesit e sotëm.

Studimet gjuhësore

Dëshmia më e rëndësishme, e cila sjell një nga provat më të rëndësishme dhe të pakundërshtueshme mbi ekzistencën e një popullsie të lashtë parahelene, etnikisht të ndryshme nga popullsia e mëvonshme greke, të cilat kishin banuar territoret e Greqisë antike, ishujt e Egjeut dhe Azinë e Vogël para se grekët të vinin në këto territore, janë një numër shumë i madh emërtimesh gjeografike, emra malesh, lumenjsh, liqenesh, vendbanimesh, emra qytetesh dhe fisesh, të cilat, - siç thotë Kretschmer - shfaqen si të huaja brenda gjuhës greke dhe nuk mund të shpjegohen dot me anë të ligjeve të kësaj gjuhe.

Pikërisht tek këto emërtime gjeografike, të cilat i gjen të shpërndara në të gjitha trevat e përmendura më lartë, të cilat shfaqnin një ngjashmëri shumë të madhe gjuhësore midis tyre, në strukturën e fjalës, në mënyrën e ndërtimit, të fjalëformimit si dhe në fonetikë, të cilat shpesh arrinin deri në përputhje të plotë fonetike, por ndryshonin krejtësisht nga gjuha greke, do të vënë re gjuhëtarët e kohëve të reja ndryshimin midis gjuhëve të fiseve të antikitetit dhe gjuhës greke. Mbi bazën e analizës gjuhësore të këtyre emërtimeve ata do të arrijnë në përfundimin e ndryshimit etnik midis fiseve pellazge dhe helene, si dhe në përfundimin që fiset greke kishin ardhur shumë vonë në këto treva.

Analiza gjuhësore e emërtimeve gjeografike merr një rëndësi të jashtëzakonshme në studimet gjuhësore, pasi këto fjalë i përkasin asaj pjese të fondit të një gjuhe, të cilat janë të lidhura ngushtë me natyrën, me tokën, me ambinetin, me kushtet gjeografike, me hapësirën. Për këtë arsye emërtimet gjeografike janë shumë të qëndrueshme dhe tregojnë një rezistencë të jashtëzakonshme përballë trysnive të jashtme. Ato arrijnë t'i rezistojnë shekujve dhe mbeten në përdorim përmes mijëvjeçarëve duke mbijetuar edhe ndryshimin e popullsisë të një vendi, edhe sikur kjo popullsi të ndryshohet disa herë. Pikërisht për këtë rezistencë të jashtëzakonshme që ato tregojnë përballë ndryshimeve etnike, bëhen dëshmi e rëndësishme e pranisë së një popullsie të caktuar, në një zonë të caktuar, në një periudhë të caktuar të historisë. Në këtë mënyrë ato afrojnë provat më të rëndësishme për të përcaktuar raportet etnike të një treve të caktuar. Tek ky material gjuhësor përfshihen emërtimet e ujrave, si emrat e lumenjve, përrenjve, liqeneve, deteve, emërtimet e tokës, si emrat e maleve, fushave,

luginave, vendeve, emërtimet e vendbanimeve të mëdha dhe të vogla si dhe emrat e fiseve dhe indirekt edhe emrat e njerëzve.

Tek këto emërtime, - thotë Kretschmer, - ruhet tipi i fjalëve të një gjuhe, të cilat ruajnë në vetvete atë material gjuhësor, i cili karakterizon një gjuhë të caktuar. Edhe nëse ky tip nuk gjendet në të gjithë fjalën, - vazhdon Kretschmer me shpjegimin e tij, - atëherë vihet re tek mbaresa apo tek prapashtesa e fjalës me të cilën ajo është krijuar.

Nëpërmjet analizës gjuhësore të këtyre emërtimeve mund të përcaktohen shpesh me saktësi raportet etnike të popullsisë që kanë banuar në një hapësirë të caktuar dhe mbi bazën e tyre bëhet e mundur që të hidhet dritë mbi etnicitetin e tyre, - thekson ai më tej.

Elementët gjuhësor më të rëndësishëm, të cilët shfaqen si elementë fjalëformues tek një numër i madh emërtimeve gjeografike janë elementet -nd-, -nth- dhe -ss-. Fjalët e krijuara mbi bazën e këtyre elementeve gjuhësore do të pranohen nga gjuhëtarët si fjalë, të cilat i përkasin fondit të gjuhëve parahelene.

Mbi bazën e krahasimeve të këtij materiali gjuhësor, gjuhëtarët do të arrijnë në përfundimin që pjesa më e madhe e emërtimeve të vendeve, ku do të vendoseshin më vonë grekët, e ka prejardhjen nga epoka parahelene. Këto emërtime do të kalojnë nga gjuha e kësaj bote të vjetër parahelene tek gjuha greke dhe do të mbeten në përdorim deri në ditët e sotme, duke u bërë dëshmi e banorëve të hershëm që kanë banuar fillimisht këto vise, të cilët do të lënë gjurmët e ekzistencës së tyre në këto emërtime.

Nga moria e të gjithë këtyre emërtimeve mund të përmendet si shembull emërtimi Nadiandos në Kappadokien, i krahasueshëm me emërtimin Aspendos në Pamphylien, me emërtimin Kamyndos në Rhodos, me emërtimin Pyrindos në Karien. etj.

Numri i këtyre emërtimeve është aq i madh - thotë Kretschmer, - sa që emërtimet greke humbasin në këtë mori. Edhe emra të njohur për veshin tonë, - shkruan Kretschmer, - si Athen, Korinth, Larisa, Theba, Mykene, Parnas, Olymp janë shumë herë më të vjetër se vetë grekët dhe historia e tyre.

Si dëshmi e kësaj ndarje sillen nga krahasimet e materialit gjuhësor edhe emërtimet e krijuara mbi bazën e së njëjtës rrënjë, të cilat shpesh shfaqen në zona, të cilat ndodhen gjeografikisht shumë largë nga njëra-tjetra. Për shembull emërtimet e krijuara mbi bazën e rrënjës myk-, të cilën e gjejmë tek emërtimi Mykarna në Aetolien, tek emërtimi Mykenai në Pelopones dhe në Kretë, tek emërtimi Mykalessos në Boiotien dhe në Karien.

Tek këto emërtime jo vetëm rrënja fjalëformuese myk- i përket gjuhës së popullsisë parahelene, por edhe prapashtesat me të cilat ato janë krijuar -arna, -enai, -essus, i përkasin po gjuhës së këtyre fiseve parahelene.

Këto emërtime të japin mundësinë të njohësh shumë lehtë ekzistencën, shtrirjen dhe shpërndarjen e fiseve parahelene në antikitet, - vë në dukje Kretschmer.

Mbi bazën e këtyre krahasimeve gjuhëtarët do të arrijnë në përfundimin që trevat e Greqisë antike, ishujt e Egjeut dhe Azia e vogël krijojnë një njësi unike gjuhësore në vetvete, e cila është e ndryshme nga gjuha greke dhe të cilat nuk mund të shpjegohen me anë të ligjeve gjuhësore të greqishtes.

Pellazgjishtja dhe ilirishtja

Kretschmer do të vinte re që elementet gjuhësore -nd-, -nth- dhe -ss- shfaqeshin jo vetëm në emërtimet gjeografike në zonat e Greqisë antike, ishujt e Egjeut dhe Azinë e vogël, por edhe

në një numër shumë të madh emërtimeh në vendet e banuara nga fiset ilire. Në vitin 1925 ai do të arrijë në një përfundim tjetër shumë të rëndësishëm, në përfundimin që elementet fjalëformuese -nd-, -nth- dhe -ss- ishin njëkohësisht edhe elemente fjalëformuese, karakteristike, të veçanta, dhe përcaktuese të gjuhës ilire. Përfundimi tjetër shumë i rëndësishëm ishte që këto elemente gjuhësore kishin ashtu sikurse tek gjuhët e fiseve të antikitit edhe në ilirisht kuptimin e përkatësisë. Të gjitha emërtimet e krijuara me këto elemente fjalëformuese do të përcaktohen si emërtime ilire, kurse zonat ku do të shfaqen këto emërtime do të përcaktohen si zona të banuara nga Ilirët.

Shumë studiues do të pranojnë që popullsia që kishte populluar trevat e Greqisë antike, ishujt e Egjeut dhe Azinë e Vogël ishte e afërt me popullsinë që banonte në zonat iliro-thrake si dhe me fiset, të cilat kishin banuar Gadishullin Apenin në antikitet.

Mommsen do të flasë për afërsinë dhe lidhjen që ekzistonte midis fiseve Japige dhe Messape që kishin banuar në antikitet pothuaj të gjithë pjesën jugore të gadishullit Apenin me fiset ilire. Ai do të flasë edhe për lidhjen e ngushtë gjuhësore që ekziston midis fiseve japigo-mesape të Italisë dhe fiseve parahelene të antikitetit të Greqisë, të ishujve të Egjeut dhe Azisë së Vogël dhe do të theksojë që kjo lidhje është pranuar tashmë nga të gjithë historikanët dhe gjuhëtarët. Krahasimet gjuhësore mbështesin përfundimin e arritur, që në të gjitha këto zona kemi të bëjmë me të njëjtën popullsi të vjetër si për Italinë edhe për Greqinë antike,- vë në dukje Mommsen.

Oberhumer shkon akoma edhe më tej dhe thotë që ai mund të paraqesë një material shumë të pasur, i cili dëshmon për afërsinë e fiseve ilire të Italisë, me fiset e Ilirisë, të Thesalisë, të Maqedonisë antike, me Thrakët, Frygët, Dakët si dhe me Etruskët e Veriut.

Fiset ilire në Gadishullin Apenin

Dëshmi e prejardhjes ilire e fiseve që kanë banuar në antikitet Gadishullin Apenin janë një numër shumë i madh emërtimeh gjeografike, të shpërndara në të gjithë këtë Gadishull, të cilat tregojnë një ngjashmëri shumë të madhe me emërtimet ilire në anën tjetër të Adriatikut, në ato vendbanime, të cilat janë të njohura historikisht si vendbanime ilire.

Si bazë krahasuese për të përcaktuar karakterin ilir të një emërtimi është zgjedhur një zonë e kufizuar shumë e ngushtë, e cila nga të dhënat historike më të hershme të antikitetit është pranuar si vendbanim ilir.

Si zonë e pastër ilire është përcaktuar Iliria Antike, e cila përfshin zonat nga Epiri në jug deri tek Danubi në veri, nga bregdeti i Adriatikut në lindje deri në Maqedoninë antike në perëndim, e njohur në antikitet me emrin Emathia, duke përfshirë këtu edhe fiset Dardane dhe Paione. Emërtimet gjeografike të kësaj zone shërbejnë si bazë krahasuese për të përcaktuar karakterin ilir të një emërtimi, i cili ndodhet gjeografikisht largë kësaj zone ilire.

Nëse në zonat, të cilat ndodhen gjeografikisht largë nga zonat që njihen si vendbanime të pastra ilire, takohen emërtime, të cilat shfaqin ngjashmëri gjuhësore me emërtimet e zonës ilire, në fonetikë, në fjalëformim, në strukturën e fjalës, në mënyrën e ndërtimit të saj, si dhe në tingëllim, emërtimet përcaktohen si emërtime ilire dhe bashkë me to, edhe vetë zonat, ku ato shfaqen njihen si - vendbanime ilire.

Qindra emërtime gjeografike të zonave të ndryshme të Gadishullit Apenin gjejnë ekuivalentin e tyre, shpesh deri në përputhje të plotë fonetike, tek emërtimet në anën tjetër të Adriatikut në viset e njohura si zona të pastra ilire. Nga krahasimet gjuhësore të nomenklaturës antike të Gadishullit Apenin është arritur në përfundimin që pjesa jugore e këtij Gadishulli, e gjithë

pjesa lindore dhe veriore e tij, deri në thellësi të pjesës qendrore dhe perëndimore të tij, kanë qënë të banuara në antikitet kryesisht nga fiset ilire. Në çdo hap që të hedhësh në Gadishullin Apenin,- thotë Krahe,- do të takosh emërtime ilire.

Nga numri jashtëzakonisht i madh i emërtimeve gjeografike të Gadishullit Apenin, të cilat janë përcaktuar si emërtime ilire do të sjellim si shembull emërtimin “Tarent”, i cili është krijuar me anë të elementit gjuhësor –nd-. Me këtë emër është emërtuar një vendbanim dhe një fis në jug të Italisë.

Kretschmer, Krahe dhe gjuhëtarë të tjerë pranojnë karakterin ilir të këtij emërtimi në radhë të parë duke u mbështetur tek elementi fjalëformues –nd-, i kësaj fjale,, i cili është përcaktuar si element ilir. Më tej gjuhëtarët mbështen tek fakti që kjo fjalë e kishte prejardhjen ose ishte ndërtuar mbi bazën e emrit Tara, i cili ishte emri i lumit në brigjet e të cilit ishte ndërtuar vendbanimi me emrin Tarent. Kjo mënyrë fjalëformimi përputhet plotësisht me ligjet gjuhësore të ilirishtes, e cila nëpërmjet këtij elementi i jep fjalëve të saj kuptimin e përkatësisë. Emri Tarent shpreh nga ky këndvështrim kuptimin “vendbanuesit e Tarës, ata që banojnë pranë Tarës”.

Emërtimi i lumit Tara është përcaktuar si emër ilir, sepse këtë emër e gjejmë edhe në viset ilire si emërtim të një dege të lumit Drinas, i cili përshkonte vendbanimet e fisit ilir të Autariatëve, por edhe si emërtim të një dege të një lumi në Parma po në Itali, i cili rridhte përmes vendbanimeve ilire në këtë zonë. Emërtimi i qyteteve sipas emrit të lumit në brigjet e të cilit ata ngriheshin është përcaktuar nga gjuhëtarët si dukuri ilire.

Praninë e fiseve ilire në Gadishullin Apenin e dëshmojnë edhe emrat e një numri të madh fisesh që kanë banuar këtë Gadishull në antikitet. Numri i këtyre fiseve është jashtëzakonisht i madh, por më të njohurit prej tyre janë fiset Messape dhe Japige, të cilët i shtrinin vendbanimet e tyre në pjesën jugore të Gadishullit Apenin si dhe fisi ilir i Venetëve, i cili i shtrinte vendbanimet e tij në pjesën lindore dhe veriore të këtij Gadishulli.

Emrat e këtyre fiseve janë përcaktuar si emra ilir, sepse ata gjejnë ekuivalentin e tyre në anën tjetër të Adriatikut në zonat e pastra Ilire. Emri i fisit ilir të Japigëve në Italinë jugore krahasohet me emrin e fisit ilir të Japudëve në Iliri. Emri i fisit Messap krahasohet me një numër shumë të madh emërtimeve në Iliri. Tek fjala Messap gjuhëtarët shikojnë një fjalë të pastër ilire, e cila është krijuar nga bashkimi i dy fjalëve të gjuhës ilire: nga fjala “mess”, e cila krahasohet me fjalën shqipe “në mes” dhe nga fjala ilire “ap”, e cila në ilirisht kishte kuptimin “ujë”. E gjithë fjala Messap ka kuptimin “në mes të ujrave”. Edhe vendbanimet e fisit ilir të Mesapëve në Gadishullin Apenin shtriheshin në një zonë, e cila ndodhej midis ujrave.

Liburnët janë një fis tjetër i njohur ilir, i cili i shtrinte vendbanimet e tij në veri të Italisë antike. Me këtë emër njihet edhe një fis në Ilirinë e veriut. Në kohën e Plinit në shek. 8 p.e.s. Liburnët jetonin akoma në Korkyra. Më vonë ata do të përndiqeshin që aty dhe do të vendoseshin në zonat veriore të Ilirisë, në jug të fisit të Enkelejve. Qyteti i tyre Buthoe ishte i ndërtuar në buzë të Adriatikut. Fisi i Enkelejve është i pranishëm jo vetëm në veri por edhe në jug të Ilirisë, vendbanimet e të cilit përmenden edhe ndërmjet fiseve të Chaonëve dhe Taulantëve në zonat jugore të Ilirisë. Kur një emër shfaqet disa herë në zona të ndryshme të ilirisë, përsëritja përforcon karakterin ilir të prejardhjes së tij.

Emri i fisit ilir Venet, i cili i shtrinte vendbanimet e tij në brigjet e Adriatikut në pjesën lindore si dhe në pjesën veriore të Italisë antike, krahasohet me emrin e fisit ilir Enetoi. Emri Venet takohet gjithashtu në përputhje të plotë fonetike tek në anën tjetër të Adriatikut tek emri i fisit ilir Venet, i cili i shtrinte vendbanimet e tij ndërmjet fiseve të Dardanëve dhe Tribalëve në Iliri. Kultura Venete do të ushtronte një ndikim të jashtëzakonshëm jo vetëm në

pjesën lindore dhe veriore të Gadishullit Apenin, por edhe në thellësi të vendeve veriore – tek Raetia e vjetër – Zvicera e sotme, në Norikum – Austria e sotme si dhe në Gjermaninë antike.

Dëshmi shumë e rëndësishme e prejardhjes ilire të fiseve që kanë banuar Italinë antike janë një numër shumë i madh mbishkrimesh të gjetura në këto zona, veçanërisht tek nekropolet e jugut, të cilat janë përcaktuar tashmë si mbishkrime ilire. Këto mbishkrime njihen me një emër të përbashkët “Shkrimet Messape”, ku përfshihen të gjitha mbishkrimet e gjetura në jug të Gadishullit Apenin dhe si “Shkrimet Venete”, ku përmbledhen të gjitha shkrimet e gjetura në veri të Gadishullit Apenin. Këto përmbledhje shkrimesh janë trashëgimia më e rëndësishme e drejtpërdrejtë nga antikiteti mbi gjuhën ilire, duke u bërë një nga thesaret më të çmuara, që na ofron njohuritë më të rëndësishme mbi gjuhën ilire.

Deri në kohët e njohura historike fisi ilir i Messapëve do të ruajë mënyrën e tij të vjetër të jetesës, e cila nga shkrimtarët e antikitetit përshkruhej si “barbare”, me kuptimin shumë e vjetër. Messapët do të ruajnë atë formë të hershme të kulturës së tyre më gjatë se të gjitha fiset e tjera ilire në Itali – shkruajnë studiuesit, - dhe nuk do të preken as nga kultura greke, e cila do të hynte aty më vonë dhe as nga zhvillimi i kulturës romake. Për këtë arsye Messapët do të përshkruheshin “statik” në zhvillimin e tyre kulturor, nga shkrimtarët e antikitetit.

Studiuesit e kohëve të reja do të shkruajnë: nëpërmjet këtyre mbishkrimeve na jepet mundësia që të dëgjojmë të flasë në gjuhën e tij një fis parahelen, na jepet mundësia të shohim në mënyrë të drejtpërdrejtë mënyrën e jetesës së epokës parahelene. Messapët shikohen si element i paster ilir në Italinë antike, i cili do të kalonte direkt nga epoka parahelene në epokën romake, nga jetesa e tij “barbare e kohëve paratrojane” direkt nën ndikimin e kulturës romake, kur pushteti i Romës do t’i jap fund ndikimit grek në Itali dhe do të shtrijë sundimin e tij edhe në këto anë.

Duke pranuar që shqipja është një gjuhë ilire, - thotë Kretschmer, - është sjellë bashkë me këtë pranim edhe prova, që populli, i cili i shkroi shkrimet e Kalabrisë, Messapët dhe Japigët, kanë ardhur nga Iliria, sepse gjuha e tyre përputhet plotësisht me tiparet më thelbësore të shqipes së sotme. Gjuhët e fiseve ilire Japige dhe Messape Kretschmer i shikon si dialekte të së njëjtës gjuhë. Edhe tek ilirishtja Kretschmer dallonte dy dialekte ashtusikurse tek shqipja e sotme.

Në këtë pikë është momenti për të vënë në dukje, rëndësinë e revidimit të historisë së mësuar në shkollë, mbi datimin e shqipes së shkruar. Në shkollë mësohet akoma që shqipja e shkruar fillon me formulën e pagëzimit të Pal Ëngjëllit.

Nga ana tjetër pranojmë prejardhjen tonë nga Ilirët dhe të gjuhës sonë nga ilirishtja. Mbi bazën e kësaj logjike si mbi bazën e këtyre shkrimeve, konkret, ekzistues mund të pranojmë direkt që shqipja e shkruar i ka fillimet e saj pikërisht tek shkrimet e fiseve ilire Japigo-Mesape dhe Venete që kanë banuar viset e Italisë antike jugore dhe veriore. Është detyra e brezit tonë të gjejmë dhe sjellim dëshmitë e trashëguara nga e kaluara dhe mbi bazën e tyre të shkruajmë të vërtetën mbi historinë tonë, por edhe të kërkojmë që dija kjo dije të shpërndahet nëpërmjet shkollës, për të rrënjosur në kujtesën e masës të vërtetën,

Emërtimet gjeografike të Italisë antike, ku kishin patur vendbanimet e tyre fiset ilire tregonin një ngjashmëri të jashtëzakonshme me emërtimet gjeografike të Greqisë antike, dhe të ishujve të Egjeut. Këto emërtime janë dëshmia konkrete e lidhjes që ekzistonte midis fiseve ilire dhe fiseve parahelene të Greqisë antike, të cilat dëshmonin edhe njëherë prejardhjen parahelene të fiseve të Greqisë antike si dhe ndryshimin etnik që ekzistonte midis tyre dhe grekëve, pasi popujt që banuan këto vise do ti emërtonin vendbanimet e tyre me emrat e gjuhës së tyre.

Si shembull për të treguar afërsinë ndërmjet këtyre gjuhëve do të sjellim emërtimin Maluntum, Maleventum, të cilin e takojmë në Samnium në Gadishullin Apenin dhe njëkohësisht në formën Maluntum në viset ilire të Dalmacisë, në formën Dymallos si emër të një mali në Iliri, dhe në formën Tritumallos po si emërtim vendi në Iliri, në formën Maloentos si emërtim në Ragusa, në formën Maluese në Dakien, në formën Malatis si emër të një kështjelle në Donauufferstrasse në zonën veriore të Ilirisë, por edhe si emër të një mbreti të fisit ilir të Tuskëve. Emërtimi në Gadishullin Apenin është përcaktuar si emërtim ilir, pasi ai gjen ekuivalentin e tij në vendbanimet ilire në anën tjetër të Adriatikut, si dhe në zona veriore të Ballkanit, ku nuk njihet prania e fiseve greke, apo ndikimi helen.

Forma të afërta, pothuaj të njëjta të këtij emërtimi takohen edhe tek emërtimet e Greqisë antike, ku e gjejmë në formën Malos në Trojë, po në formën Malos si emër lumi në Arkadien, në formën Maloeis në Lesbo dhe si emërtim vendi në Mytilenë, në formën Maleos në Peloponez, në Lakonien dhe në Lesbos, por edhe si emrin e dytë karakterizues të hyjnisë Apollon – si Apollon Maleos. Të gjitha këto emërtime kanë në bazë të tyre rrënjën mal-, të cilën gjuhëtarët e lidhin me fjalën shqipe mal-, dhe mbi këtë bazë pranojnë që të gjitha vendet ku shfaqen emërtimet e krijuara me këtë rrënjë kanë qënë të banuara nga fise të afërta etnikisht me njëri-tjetrin - nga fiset ilire - si në Gadishullin Apenin ashtu edhe në veri të Ballkanit, në Iliri. Këto emërtime bëhen dëshmi e rëndësishme e lidhjes etnike midis fiseve ilire dhe fiseve parahelene të Greqisë antike, e karakterit parahelenë të këtyre fiseve, si dhe i ndarjes ndërmjet tyre dhe grekëve.

Europa antike dhe Ilirët

Nga analiza gjuhësore e emërtimeve të Europës së vjetër gjuhëtarët do të pranonin që Gjermania, Zvicëra, Austria dhe vende të tjera në veri të Danubit deri në Detin Baltik, kishin qënë në një periudhë të hershme të historisë të banuara nga fiset ilire. Përpara se keltët të përhapeshin në ato vendabnime, të cilat do të banoheshin më vonë nga fiset gjermane, shkruan Krahe,- ato kishin qënë për një periudhë disa qindvjeçare të banuara nga fiset ilire. Dëshmi e pranisë ilire tek të gjitha këto vendbanime janë emërtimet gjeografike, të cilat nuk mund të shpjegohen as me gjuhën gjermane, as me keltishten dhe as me latinishten, por mund të shpjegohen shumë lehtë me anë të ilirishtes, - shpjegon Kretschmer dhe Krahe.

Ilirët do të shikohen si mbartësit e dy kulturave më të hershme të kontinentit European, të kulturës së njohur me emrin “Kultura e Lausitz”, e cila u zhvillua rreth shekullit të 14 p.e.s. si dhe i kulturës së njohur me emrin “Kultura e Urnëve”, e cila do të ngrihej mbi bazën e kulturës së Lausitz-it dhe do të lulëzonte rreth shek të 13. p.e.s.

Kultura e Urnëve do të karakterizohej si një kulturë me një zhvillim dhe me një përhapje hapësinore të jashtëzakonshme në kontinentin European. Gjurmët e saj gjenden të shtrira pothuaj në të gjithë kontinentin dhe kudo ku ato shfaqen takohen edhe emërtimet ilire.

Në shekullin e 13 p.e.s. Ilirët kishin qënë në stadin e një zhvillimi jashtëzakonisht të fuqishëm, thekson Krahe ,- ata kishin arritur “stadin e fuqisë së tyre më të lartë”, të ekspansionit më të gjerë, ishin bërë mbartësit e një lëvizjeje të jashtëzakonshme.

Mbi bazën e kulturës së Lausitz-it do të ngrihej më vonë kultura e Hallstatit, sipas emrit të një qyteti në Norikum antik, në Austrinë e sotme, e cila është përcaktuar plotësisht si kulturë ilire dhe njihet me emrin “Kultura ilire e Hallstatit”. Kjo kulturë do të gjente një përhapje të gjerë në Gjermani, Austri, Zvicër, Poloni. Të gjitha zonat, ku do të lulëzonte kultura e Hallstatit krijojnë rreth viteve 700 p.e.s. një njësi unike, e cila i përket “Kulturës ilire” - do të theksojnë

studiues të ndryshëm. Përsa i përket Alpeve Austriake ishte sjellë me kohë karakteri ilir i këtyre zonave.

Në fund të Epokës së Bronxit dhe në fillim të Epokës së Hekurit rreth shek të 12 p.e.s. do të banohet e gjithë zona, ku shtrihej kultura e hershme e protokeltëve nga Ilirët. E gjithë periudha e Hekurit në Europë do të njihet si kulturë Ilire. Vetë ilirët ishin prodhuesit dhe shpërndarësit më të mëdhenj të hekurit në Europë.

Si mbartës të një kulture të qëndrueshme dhe të fuqishme, e cila gjeti zgjerimin më të madh në Europën e vjetër, e cila mbisundoi për disa qindra vjet në zona të ndryshme të kontinetit European, Ilirët do të emërtonin me fjalët e gjuhës së tyre edhe malet, lumenjtë dhe liqenet, qëndrat dhe vendbanimet më të rëndësishme të kësaj Europe të vjetër,- thotë Pokorny.

Gjermania, Austria dhe Zvicera, Hungaria dhe Polonia kanë qënë të banuara për një periudhë qindrvjeçare nga fiset ilire, para se aty të vinin fiset kelte dhe gjermane. Praninë ilire në këto zona e dëshmojnë një numër jashtëzakonisht i madh emërtimesh gjeografike, të cilat janë përcaktuar nga gjuhësia si emërtime ilire, të cilat shfaqen veçanërisht tek Hydronimia e Europës së vjetër. Edhe vetë emrin i Detit Baltik gjuhëtarët e fusin në fondin e ilirishtes dhe e shpjegojnë me anë të fjalës shqipe - “Balta”.

Si shembull mund të sjellim emrin e fisit **Leukaristos** nga “Germania Magna” e Ptolemeut, i cili takohet në territoret e banuara sot nga gjermanët. Ky emërtim nuk mund të shpjegohet me anë të gjermanishtes, si nga mënyra e fjalëformimit ashtu edhe nga elementet gjuhësore që i janë bashkangjitur rrënjës së kësaj fjale. Elementi fjalëformues –st- është përcaktuar si element tipik fjalëformues i ilirishtes, i cili gjithashtu ka kuptimin e përkatësisë. Prandaj emri Leukaristos është përcaktuar si emër ilir, pasi është krijuar me anë të elementeve të kësaj gjuhe, por edhe sepse njihen krijime të njëjta me emrin Leukaristo edhe në Iliri si p.sh. emri, Audaristos, i cili tregon kuptimin e përkatësisë “vendbanimi i Audarios”.

Me elementin gjuhësor –st- janë krijuar një numër shumë i madh emërtimesh gjeografike të shpërndara pothuaj në të gjithë Europën e vjetër, për të cilat Krahe njih përkatësinë e tyre ilire dhe i fut ato në fondin e emërtimeve hydronimike të Europës së vjetër.

Siç u përmend edhe më lartë kultura Venete do të ushtronte një ndikim të madh në të gjithë Europën antike. Emërtimet e krijuara mbi bazën e rrënjës së fjalës Venet- do ti gjejmë të shtrira pothuaj në të gjithë Europën e vjetër, veçanërisht në zonat e Austrisë dhe Gjermanisë antike. Në këto treva takohen edhe emra fisesh të krijuar mbi bazën e rrënjës së fjalës Venet, si fisi i Venoste në Norikum.

Emri i vjetër i Bodensee në Gjermani ishte “Lakus Venetus”. Prania e emërtimeve të krijuar mbi bazën e rrënjës së fjalës Venet është dëshmi e pranisë ilire në të gjitha ato vise, ku ai shfaqet. Emri Venet shpjegohet nga gjuhëtarët me anë të fjalës shqipe - “vend”.

Edhe Alfabetin e tyre të parë fiset gjermane do ta marrin nga fisi ilir i Venetëve, të cilin do ta mbajnë në përdorim për një kohë të gjatë deri sa të zhvillojnë mbi këtë bazë alfabetin e tyre i njohur si “Alfabeti i Runeve”. Edhe vetë prejardhjen e emrit Deutschland – Gjermani – gjuhëtarët e shikojnë tek fjala Teuton, dhe e lidhin me emrin “Teuta”. Emri Teuta është përcaktuar si emër i pastër ilir.

Për lidhjet midis gjermanishtes dhe ilirishtes ka shkruar shumë gjerë Krahe. Krahe thekson midis të tjerash që shumë elemente gjuhësore të gjermanishtes gjejnë ekuivalentin e tyre vetëm tek gjuha ilire dhe mund të shpjegohen vetëm me anë të ilirishtes.

Duke filluar nga Gjermania, Zvicera, Austria, Polonia, Hungaria në qëndër dhe në lindje të kontinetit European, nga Franca, Hollanda, Spanja, Portugalia, Gadishulli Apenin dhe Ballkani në perëndim dhe në jug të këtij kontinenti deri në veri në Angli do të gjenden emërtime ilire dhe gjurmë të fiseve Ilire që kanë banuar këto zona.

Nga e gjithë analiza e emërtimeve gjeografike do te arrihet në përfundimin që Azia e vogël dhe Greqia antike, pjesë të mëdha të Ballkanit, pjesë të mëdha të Gadishullit Apenin, Pannonia e vjetër, Gjermania, Austria dhe Zvicera, Polonia, Franca, Hollanda Spanja Portugalia, Franca, Hollanda, Belgien si dhe Britania deri në Detin Balltik në veri kanë qënë për një periudhë disaqindravjeçare të banuara nga fise ilire.

Një shtrirje hapësinore me përmasa imponuese,- thotë Krahe.

Përcaktimi i një hapësire të përmasave të tilla si hapësirë ilire, ku pothuaj i gjithë kontinenti European ka qënë i banuar për disa qindra vjet kryesisht nga fiset ilire, është plotësisht i pranueshëm, - thotë Krahe,- përse kohë ky përcaktim mbështetet mbi metoda dhe kritere të përcaktuara gjuhësore, linguistike.

Ne thotë Krahe vetëm mund të mrekullohemi duke parë këto përmasa jashtëzakonisht të mëdha të shpërndarjes ilire, por duhet edhe ta pranojmë si një fakt historik, ekzistues shpërndarjen e tyre hapësinore.

Fiset ilire janë hallka lidhëse e gjuhëve të kontinetit tonë, pa të cilat nuk mund të kuptohet historia e hershme e tij.

Literatur

Busolt, Georg: Griechische Geschichte bis zur Schlacht bei Chaironeia. 1. Teil. Bis zur der Perserkriegen. Friedrich andreas Perthes, Gotha, 1883.

Brandenstein, Wilhelm: Die Völkerschichten in den Ostalpen im Lichte der Ortsnamen: Zeitschrift der deutschen und österreichischen Alpenvereins, 1935.

Diefenbach, Lorenz: Die alten Völker Europas mit ihren Sippen und Nachbarn. Verlag von Joseph Baer, Frankfurt am Main, 1861.

Fick, August: Vorgriechische Ortsnamen als Quelle für die Vorgeschichte Griechenlands. Vandenhoeck und Ruprecht, Göttingen, 1905.

Fligier Cornelius: Zur Prähistorischen Ethnologie Italiens. Urzeit von Hellas und Rom. Alfred Hölder, K & K. Hof- und Universitäts Buchhändler, Wien, 1877.

Helbig, W.: Studien über die älteste italische Geschichte. In: Hermes Nr. 11, Heft 3. Zeitschrift für classische Philologie. Untermitwirkung von R. Hercher, A. Kirchhof, Th. Mommsen, J. Vahlen. Hübner, Emil (hrsg.), 11 Band, Weidmansche Buchhandlung, Berlin, 1876.

Hesselmeyer, Ellis Dr.: Die Pelasgerfrage und ihre Lösbarkeit. Verlag von Franz Fues, Tübingen, 1890.

Krahe, Hans: Die alten balkanillyrischen geographischen Namen auf Grund von Autoren und Inschriften. Indogermanische Bibliothek. Hrsg. von H. Hirt und W. Streitberg. Dritte Abteilung: Untersuchungen: Carl Winter. Universitätsverlag. Heidelberg, 1925.

Krahe, Hans: Germanisch und Illyrisch. In: Arntz, Helmut (Hrsg.). Germanen und Indogermanen. Volkstum, Sprache, Heimat, Kultur. Festschrift für Herman Hirt. Zweiter Band, Carl Winters Universitätsbuchhandlung, Heidelberg, 1936.

Krahe, Hans: Die Illyrier in ihren sprachlichen Beziehungen zu Italikern und Griechen. Die Illyrier in Italien. In: Die Welt als Geschichte. Zeitschrift für Universalgeschichte. Stier, Hans Erich (Hrsg.). Verlag, Stuttgart-S, Jg. 1 – 25, 1935 – 1963.

Kretschmer, Paul: Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache. Vandenoëck & Ruprecht, Göttingen, 1896.

Kretschmer, Paul: nt- Suffix indoeuropäisch. In: Glotta. Zeitschrift für Griechische und lateinische Sprache. Kretschmer, Paul und Skutsch, Franz (Hrsg.). Band XIX. Vandenoëck und Ruprecht, 1925.

Kretschmer, Paul: Zur Geschichte der griechischen Dialekte. In: Glotta. Zeitschrift für griechische und lateinische Sprache. Kretschmer, Paul und Skutsch, Franz (Hrsg.). I. Band, 4 Heft. Vandenoëck und Ruprecht, 1907.

Lochner-Hüttenbach, Fritz: Die Pelasger. Gerold & Co. Wien, 1960.

Mommsen, Theodor: Die unteritalischen Dialekte. Georg Wigand's Verlag, Leipzig, 1850.

Oberhumme, Eugen, Dr.: Akarnanien, Ambrakia, Amphilokien, Leukas im Altertum. Theodor Ackermann, München 1887.

Pauli, Carl: Die Veneter und ihre Schriftdenkmäler. Johann Ambrosius Barth, Leipzig, 1891.

Pokorny, Julius: Indogermanisches etymologisches Wörterbuch, Bd. 1-2. Francke, Bern, München, 1959 – 1969.

Thumser, Viktor: Hermann, Karl Friedrich: Lehrbuch der Griechischen Staatsaltertümer. Hrsg. Viktor Thumser. Erste Abteilung: Akademische Verlagsbuchhandlung von J.C.B. Paul Siebeck, Freiburg, 1889.

Shpresa MUSAJ, MA
Studiuese në fushën e historisë dhe gjuhësisë

25.4.2019